

Federata Shqiptare e Basketbollit, ka nisur punën e menjëhershme për implementimin e projektit, në bashkëpunim me shoqatat anëtare dhe Bashkinë e Tiranës, si autoriteti përgjegjës i palestrave të shkollave, ku starton dhe projekti . Në tabelën e mëposhtme ju paraqesim të dhënat mbi shkollat ku është implementuar projekti gjatë fazës së parë të tij, instruktorët dhe numuri i fëmijëve të përfshirë, si edhe seancat stërvitore për çdo muaj.

Palestrat e shkollave në Tiranë

Nr	Emri i Shkollës	Emri i Instruktorëve	Nr i fëmijëve në çdo shkollë	Seancat mujore
1	Niket Dardani	Arnold Laperi	55 fëmijë	20 seanca mujore
2	Naim Frashëri	Astrit Greva	60 fëmijë	25 seanca mujore
3	At Zef Pllumi	Mikel Serbo	40 fëmijë	20 seanca mujore
4	Qemal Stafa	Roland Avrami	35 fëmijë	20 seanca mujore
5	4 Dëshmorët	Marlin Sukaj	37 fëmijë	20 seanca mujore
6	Kosova	Elidon Beqo	25 fëmijë	15 seanca mujore
7	Ahmet Gashi	Mirsad Adili	40 fëmijë	20 seanca mujore
8	Shkolla Kuqe	Shyqyri Lazimi	45 fëmijë	20 seanca mujore
9	Qazim Turdiu	Glen Prodani	40 fëmijë	20 seanca mujore
10	Kongresi Manastirit	Altin Cico	23 fëmijë	15 seanca mujore
11	Emin Duraku	Gazment Caci	30 fëmijë	15 seanca mujore
			Totali 430 fëmijë	Total=210 seanca

Nisur nga vënia në dispozicion e një numri të gjerë palestrash, të përfshira në projekt, dhe interesin e vashdueshëm që komuniteti që ka për sportin e bukur të basketbollit, është vënë re dhe rritja e numrit të fëmijëve, të cilët dëshirojnë të merren me këtë sport duke kapur shifrën e 400 fëmijëve (duhet theksuar vetëm në fazën e parë të zbatimit të këtij projekti). Marrëveshja e bashkëpunimit midis MASR dhe FSHB, ka filluar të japë rezultate dhe një frymëmarrje të ndryshme, sa i përket klimës sportive, dhe jo vetëm, por edhe nga lehtësia e përfshirjes së këtyre fëmijëve duke marrë parasysh afërsinë me shkollën me shtëpitë. Nisur nga sa më sipër, tendenca e përfshirjes dhe masivizimit, ndër objektivat kryesorë të këtij projekti, do të ketë shifra dhe rezultate mjaft të kënaqshme

Po ashtu, Federata Shqiptare e Basketbollit, ka ofruar asistencën e saj nëpërmjet trajnimeve, klinikave me ekspertë të huaj dhe vendas, për rritjen e nivelit profesional të trajnerëve të përfshirë në projekt. Në një hark kohor prej 6 muajsh, nga FSHB janë licencuar 30 trajnerë të rinj, potencialë për tu përfshirë në projekt duke bërë të mundur, rritjen e numrit të fëmijëve në secilën nga shkollat e lartpërmendura.

Në mënyrë periodike, nga punonjësit e FSHB-së, është bërë ndjekja e punës në të gjitha palestrat për të parë ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit stërvitor në secilat nga shkollat.

Po ashtu vlen për tu theksuar se , nga ne është bërë dhe pajisja e të gjitha shkollave, pjesë e projektit me bazë materiale (Topa basketbolli për të gjitha moshat) për t'i shërbyer procesit stërvitor në secilën nga shkollat.

Gjithashtu, po gjatë kësaj periudhe ,janë organizuar dhe aktivitete të ndryshme si kampionat me 12 vjeçarë dhe kupa me 14 vjeçarë. Si dhe kampionate ndërmjet klasave.

Në,12 Mars 2018, në palestrën e shkollës “Qazim Turdiu” është zhvilluar kampionati ndërmjet klasave, ku janë zhvilluar gjithsej 12 neshje dhe kanë qënë të pranishëm 100 fëmijë.



Në 12 Maj 2018 në palestrën e shkollës “4 Dëshmorët” është zhvilluar Turneu me 14 vjeçarë, ku morën pjesë, 6 ekipe të shkollave, 4 Dëshmorët, Shkolla e Kuqe, Kongresi Manastirit, Niket Dardani, Ardhmëria, Qazim Turdiu ,janë zhvilluar 7 ndeshje gjithsej dhe kanë qënë të pranishëm 90 fëmijë.



Në 12 qershor 2018, në palestrën e Shkollës së “Kuqe” është zhvilluar kampionati i 12 vjeçarëve, me pjesëmarrjen e 7 ekipeve : 4 Dëshmorët, Shkolla Kuqe, Kongresi Manastirit, Niket Dardan, Ardhmëria, Qazim Turdiu dhe Naim Frashëri. Aktiviteti ka zgjatur 4 javë dhe janë zhvilluar 25 ndeshje gjithsej, nga ku janë aktivizuar rreth 110 fëmijë.



Në , 10.11.2018 në palestrën e shkollës “ At Zef Pllumbi” është zhvilluar Turneu me 14 vjeçarë, me pjesëmarrjen e 4 ekipeve, përkatësisht të shkollave: 4 Dëshmorët, Shkolla e Kuqe, Kongresi Manastirit, , Qazim Turdiu. Janë zhvilluar 4 ndeshje gjithsej dhe kanë qënë të pranishëm 60 fëmijë.

PS: Duke falenderuar të gjithë bashkëpunëtorët tanë, veçanërisht MASR dhe Bashkinë Tiranë, ne garantojmë se ky bashkëpunim do të arrijë dimensione me efekte edhe më të gjera përveç atij sportiv, si rritje e cilësisë sportive, efekte sociale dhe shëndetësore, kulturore dhe bashkëpunim i ngushtë, në nivele më të ulëta strukturash organizative si shoqatat e basketbollit, drejtoritë e shkollave, drejtoritë arsimore e me gjerë.